



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**RREGULLORE(QRK) Nr. 04/2025 PËR MËNYRËN E MBAJTJES SË
EVIDENCËS SË SENDEVE TË LUAJTSHME DHE TË PALUAJTSHME
DHE E REGJISTRIMIT TË SENDEVE NË PRONËSI PUBLIKE¹**

¹ Rregullore (QRK) Nr. 04/2025 për Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës së Sendeve të Luajtshme dhe të Paluajtshme dhe e Regjistrimit të Sendeve në Pronësi Publike, është miratuar në Mbledhjen e 251-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.20/251, të datës 12.03.2025.

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 (4) të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, si dhe nenit 8 (4.5) të Ligjit Nr.08/1-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) Nr. 04/2025 PËR MËNYRËN E MBAJTJES SË EVIDENCËS SË SENDEVE TË LUAJTSHME DHE TË PALUAJTSHME DHE E REGJISTRIMIT TË SENDEVE NË PRONËSI PUBLIKE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për mënyrën e mbajtjes së evidencës së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme dhe e regjistrimit të sendeve në pronësi publike.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet nga Zyra për Administrimin e Pronës Publike (me tutje: Zyra) në Zyrën e Kryeministrit dhe gjitha institucionet qendrore të Republikës së Kosovës dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, të cilat menaxhojnë apo kanë në shfrytëzim pasurinë publike të përcaktuar në ligj, duke përfshirë pasuritë e paluajtshme dhe sendet e luajtshme.

Neni 3 Evidenca e pronës së paluajtshme dhe të luajtshme

1. Zyra mban dhe përditëson Evidencën Unike dhe Regjistrin e Pronës Publike, duke përfshirë edhe pronat publike të cilat kategorizohen si infrastrukturë kritike, duke ofruar qasje dhe menaxhim të centralizuar të këtyre të dhënave.
2. Evidenca Unike dhe Regjistri i Pronës Publike përmban dy regjistra të posaçëm: Regjistrin e Pronës së Paluajtshme dhe Regjistrin e Sendeve të Luajtshme.

Neni 4

Mbajtja e evidencës së paluajtshmërive

1. Organet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale mbajnë evidencën e paluajtshmërive të cilën e disponojnë. Të dhënat e përfshira në këtë evidencë duhet të jenë në përputhje me të dhënat kadastrale përkatëse.
2. Organet e sipërpërmendura janë të obliguara që të dhënat e mbajtura t'ia dërgojnë me kohë Zyrës në pajtim me Ligjin përkatës për Pronën Publike dhe me këtë rregullore.

Neni 5

Regjistri i Pronës së Paluajtshme

1. Zyra mban Regjistrin e Pronës së Paluajtshme, i cili përbën një regjistër unik për gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Regjistri unik përfshin informacionet bazë për secilën pronë, duke përfshirë:
 - 2.1. numrin e ngastrës kadastrale;
 - 2.2. zonën kadastrale;
 - 2.3. vendndodhjen, që përfshin adresën e sakte dhe adresat e mëhershme të evidentuara;
 - 2.4. sipërfaqen e ngastrës;
 - 2.5. objekti fizik (ndërtesa);
 - 2.6. sipërfaqja e objektit;
 - 2.7. certifikatën e pronësisë;
 - 2.8. numrin e certifikatës së pronësisë;
 - 2.9. destinimin;
 - 2.10. servitutin, barrën sendore dhe/ose kufizimet tjera;
 - 2.11. baza e fitimi të pronësisë që përfshin certifikatën e pronësisë (jo me te vjetër se gjashtë muaj), vendimin administrativ ose ndonjë akt tjetër përkatës, dhe
 - 2.12. vlera e pronës së paluajtshme në momentin e evidentimit.
3. Zyra mund të kërkojë edhe të dhëna të tjera të nevojshme për administrimin efektiv dhe efikas të Regjistrit të Pronës së Paluajtshme.

4.Në rastet kur institucionet vetëm shfrytëzojnë pronën e paluajtshme dhe nuk kanë qasje në të dhënat kadastrale duhet që për këtë të njoftojnë Zyrën.

5.Organet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara që në Regjistër të vendosin një shenjë të veçantë me qasje të kufizuar, e cila tregon nëse prona përkatëse në pronë publike përbën infrastrukturë kritike.

Neni 6

Evidentimi i servitutit dhe barrës tjetër sendore

1.Çdo servitut ose barrë tjetër sendore që prek pasurinë publike duhet të regjistrohet saktësisht në Regjistër, duke përfshirë shënimet mbi palët e përfshira, kohëzgjatjen ose afatin e përdorimit.

2.Organi që menaxhon pasurinë publike mban përgjegjësi për përditësimin e të dhënave që kanë të bëjnë me servitutin dhe barrën tjetër sendore.

Neni 7

Vlera e pronës së paluajtshme

1.Regjistri i Pronës së Paluajtshme përmban edhe vlerën e pronës së paluajtshme në momentin e evidentimit të saj.

2.Vlerësimi i pronës së paluajtshme kryhet nga personat ose institucionet e licencuara, bazuar në standardet profesionale dhe legjislacionin në fuqi.

3.Kostoja e vlerësimit mbulohet nga subjekti që inicion regjistrimin ose nga institucioni përgjegjës, sipas dispozitave ligjore përkatëse. Vlerësimi mund të përditësohet në rastet kur ka ndryshime të rëndësishme në karakteristikat e pronës apo sipas afateve të përcaktuara me ligj.

Neni 8

Afati për regjistrim dhe përditësim

1.Organet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara të realizojnë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme me gjendjen e datës 31 dhjetor të atij viti.

2.Të dhënat e regjistruara dorëzohen te Zyra brenda afatit të përcaktuar, e së paku jo më vonë se 31 mars i vitit vijues.

3.Çdo ndryshim që ndodh gjatë vitit kalendarik duhet të bëhet i njohur brenda 30 ditësh nga data e ndryshimit.

Neni 9

Regjistrimi i pronës publike si pronë e Republikës së Kosovës

Në pajtim me nenin 31 të Ligjit për Pronën Publike, pas pranimi të të gjitha të dhënave, Zyra inicion regjistrimin në Agjencinë Kadastrale të Kosovës të pronës publike në emër të Republikës së Kosovës, për pronat që shfrytëzohen nga institucionet qendrore, ose në emër të komunave, për pronat që shfrytëzohen nga njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Neni 10

Evidenca e sendeve të luajtshme

1. Organet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale mbajnë evidencën e sendeve të luajtshme që kanë në dispozicion, sipas nenit 29 të Ligjit përkatës për Pronën Publike.
2. Kjo evidencë duhet të pasqyrojë: gjendjen fizike, vlerën financiare, si dhe lëvizjet e sendeve gjatë vitit (blerjet, çregjistrimet, transferimet etj).
3. Vlerësimet fillestare dhe ato të mëvonshme regjistrohen në regjistrat kontabël përkatëse, në pajtim me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Regjistrat kontabël e sendeve të luajtshme dhe lidhja me platformën e-Pasuria

1. Të gjitha sendet e luajtshme në pronësi publike regjistrohen në përputhje me standardet e kontabilitetit publik dhe procedurat e caktuara nga institucionet përgjegjëse.
2. Regjistrimi fillestar bazohet në vlerën e blerjes ose, në mungesë të dokumentacionit financiar, në vlerësimin e organit kompetent. Nëse ekziston vlerë e përcaktuar kontabël, nuk është i domosdoshëm vlerësimi i ri.
3. Çdo ndryshim në vlerë ose në gjendje fizike (blerje shtesë, dëmtim, asgjësim, transferim) pasqyrohet menjëherë në platformën e-Pasuria dhe në regjistrat kontabël, sipas legjislacionit përkatës.

Neni 12

Ruajtja dhe siguria e të dhënave

Të dhënat në regjistrin elektronik ruhen në pajtim me rregullat e sigurisë së sistemeve informative, duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 13

Koordinimi ndërinstitutional

Zyra, organet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë të dhëna me qëllim të ruajtjes së saktësisë dhe përditësimit të informacionit mbi pasurinë publike.

Neni 14
Raportimi vjetor për sendet e luajtshme

1. Organet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale, jo më larg se data 31 mars e vitit pasardhës, dorëzojnë raportin vjetor në formë elektronike te Zyra.
2. Raporti vjetor përfshin gjendjen në datën 31 dhjetor të vitit paraprak, si dhe çdo ndryshim të realizuar gjatë atij viti.

Neni 15
Raportimi publik dhe transparenca

1. Zyra përgatitë dhe publikon raporte periodike mbi pasurinë publike, duke u bazuar në informacionet e grumbulluara nga organet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.
2. Publikimi i raporteve realizohet duke respektuar dispozitat ligjore për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, si dhe duke pasur parasysh interesin publik për informim.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

20 mars 2025